



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo



Komuna e Prishtinës
Opština Priština – Municipality of Prishtina

Në bazë të nenit 12, paragrafi 12.2, shkronja **d** të Ligjit nr. 03/L – 040, për vetëqeverisje lokale ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës", nr. 28/15, qershor 2008), të nenit 7 të Ligjit nr. 04/L – 071, për sistemin e adresave ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës", nr. 29/27, dhjetor 2011), dhe të nenit 34, paragrafi 34.1, shkronja **d** të Statutit të Komunës së Prishtinës, 01. nr. 110 – 391, të dt. 25.02.2010, Kuvendi i Komunës së Prishtinës, në mbledhjen e mbajtur më 05.06.2019, merr këtë

V E N D I M

- I. **M I R A T O H E T** Vendimi për emërtimin e rrugës, segmenti i së cilës shtrihet me fillim nga rrethrotullimi (urë), në hyrje të qytetit nga drejtimi i Fushë-Kosovës, përgjatë anës së epërme të hekurudhës në lagjen "Arbëria" deri në rrethrotullimin në fund të kësaj lagjeje, gjegjësisht kryqëzimin e rrugëve "Ahmet Krasniqi" dhe "Tirana", me emrin "Bernard Kushner."
- II. Rruga e cekur në nenin I të këtij vendimi, është rrugë e re.
- III. Për zbatimin e këtij vendimi kujdeset Kryetari i Komunës dhe drejtoritë përgjegjëse.
- IV. Ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në Zyrën e protokollit të Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal dhe publikimit në gjuhë zyrtare në ueb-faqen e Komunës.

KUVENDI I KOMUNËS SË PRISHTINËS
01-343/02-129443/19, më 06.06.2019

KRYESUESI I KUVENDIT
Agim Kuleta

